



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
ëëë.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201501302/27

Tiranë ___/___/2016

Lënda : *Rekomandim për shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë për pushimin e hetimeve të procedimit penal me nr. 671, të vitit 2015.*

Drejtuar : Prokurorit të Përgjithshëm
Z. Adriatik LLALLA

Tiranë

I nderuar zoti Llalla,

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), ka marrë në shqyrtim ankesën e shtetasit M.Gj., i arrestuar në IEVP Lezhë, për të cilën është vënë në dijeni nga ana e familjarëve të tij se, ai është keqtrajtuar nga ana e forcave të Policisë së Shtetit gjatë aksionit policor për ndalimin e vrasësit të dyshuar të dy turistëve çekë në Komunën Rrethina, Qarku Shkodër.

Nga hetimi administrativ, shqyrtimi i provave e materialeve që lidhen me këtë çështje dhe nga kontakti që pati një ndihmëskomisioner i institucionit tonë me shtetasin M.Gj. në IEVP Lezhë në datën 13.07.2015, u konstatuan shenja dhune në fytyrën dhe në trupin e tij.

Gjatë hetimit administrativ të këtij rasti, ndihmëskomisioneri i institucionit tonë konstatoi se, i paraburgosuri M.Gj. në datën 08.07.2015 ka dalë para komisionit të pritjes të IEVP Lezhë. Ky komision ka mbajtur procesverbalin përkatës, kopja e të cilit është marrë dhe administruar nga punonjësi ynë. Sipas këtij procesverbali rezulton se, në datën 08.07.2015, kur është paraqitur i paraburgosuri M.Gj. në komisionin e pritjes kanë qënë vetëm tre anëtarë të këtij komisioni dhe konkretisht, përfaqësuesi i sektorit ligjor Adrian Çeka, përfaqësuesi i sektorit të ruajtjes dhe sigurisë Ëngjëll Zefi dhe përfaqësuesi i sektorit të shëndetësisë Ndue Deda. Ndërsa përfaqësuesi i sektorit të kujdesit social nuk ka qënë. Nga përmbajtja e procesverbalit të mbajtur nga komisioni i pritjes rezulton se gjendja shëndetësore e të paraburgosurit M.Gj. është pa probleme dhe e mirë.

Theksojmë se, në dokumentacionin shoqërues të dërguar nga Komisariati i Policisë Shkodër në IEVP Lezhë është edhe kartela ditore e

shtetasit M.Gj. e përpiluar në datën 06.07.2015 nga nd/mjeku i Komisarariatit të Policisë 731 FNSH Shkodër, Lulzim Kukaj. Në këtë kartelë është pasqyruar fakti se, tek i arrestuari janë konstatuar "Laceracione" (shënja dhune) në pjesë të ndryshme të trupit. Ndërkohë sikurse përshkruam edhe më sipër, shënjat e dhunës në fytyrën dhe në trupin e ankuesit janë konstatuar edhe nga ndihmëskomisioneri i institucionit tonë kur u takua me të në datën 13.07.2015, pas disa ditësh nga paraqitja e tij në komisionin e pritjes.

Sjellim në vëmendje se, në nenin 30 të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe e të paraburgosurve", i ndryshuar, (Pranimi në institucion) parashikohet se:

"Në çdo institucion krijohet komisioni i pritjes për të pranuar të sapoardhurit. Komisioni informon të paraburgosurin dhe të dënuarin në një gjuhë të kuptueshme për rregulloren e institucionit, të drejtat dhe detyrimet e tij, të drejtat e tij për këshillim e ndihmë ligjore, rregullat e procedurat për paraqitjen e kërkesave e të ankesave.

Autoritetet e institucionit i pajisin menjëherë të paraburgosurit dhe të dënuarit me informacion të shkruar për rregullat në institucion, të drejtat dhe detyrimet e tyre. Të paraburgosurit dhe të dënuarit që i përkasin minoriteteve etnike ose gjuhësore, të huaj ose persona pa shtetësi, pajisen me informacion me gojë dhe me shkrim, në gjuhën që e kuptojnë, për të drejtat dhe detyrimet e tyre në institucion. I dënuari ka të drejtë të mbajë informacionin me shkrim për vete.

Menjëherë pas pranimit, drejtuesit e institucionit i mundësojnë të paraburgosurit dhe të dënuarit të huaj njoftimin e familjes, këshilltarit ligjor, përfaqësuesit konsullor ose organizatës kompetente që vepron në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Shtetasve të huaj, që nuk kanë përfaqësi diplomatike ose konsullore në vend, refugjatëve ose personave pa shtetësi u mundësohet komunikimi me përfaqësitë diplomatike të shtetit që mbron interesat e tyre ose me autoritetin kombëtar ose ndërkombëtar, detyra e të cilit është mbrojtja e interesave të këtyre personave.

Pas momentit të pranimit në institucion, të sapoardhurit menjëherë duhet t'i nënshtrohen një vizite ekzaminuese dhe interviste mjekësore nga ana e mjekut të institucionit për njohjen dhe parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse në institucion, vetëvrasjeve, regjistrimin e plagëve dhe dëmtimeve në kohën e duhur.

Shënjat e dëmtimeve fizike, të identifikuar në vizitën e pranimit, duhet të regjistrohen në një regjistër të veçantë së bashku me shpjegimet e të sapoardhurit rreth rrethanave të shkaktuara.

Mjeku, në rast se i kërkohet, duhet të pajisë të sapoardhurin me një certifikatë mjekësore, e cila shpjegon gjendjen e lëndimeve dhe rrethanat e tjera.

Mbi bazën e dokumentacionit shoqërues, të shpjegimeve verbale e të formularit të vlerësimit të riskut, vlerësohen të dhënat individuale të të paraburgosurit dhe të dënuarit lidhur me personalitetin e tij.

Mbi bazën e këtyre të dhënave përpilohet regjistri i komisionit të pritjes, dokumentacioni përkatës, sipas shërbimeve dhe programohet në vazhdim trajtimi individual për të paraburgosurin dhe të dënuarin."

Ndërsa në nenin 13 të VKM nr. 407 datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve” (Veprimet paraprake gjatë pranimit) parashikohet se:

“1. Pas momentit të pranimit në institucion, të sapoardhurit menjëherë i nënshtrohen një vizite ekzaminuese dhe interviste mjekësore nga ana e mjekut të institucionit për njohjen dhe parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse në institucion, vetëvrasjeve, regjistrimin e plagëve dhe dëmtimeve në kohën e duhur, duke respektuar parimin e konfidencialitetit.

2. Shenjat e dëmtimeve fizike, të identifikuara në vizitën e pranimit, duhet të regjistrohen në një regjistër të veçantë së bashku me shpjegimet e të sapoardhurit mbi rrethanat e shkaktuara dhe njoftohet menjëherë drejtuesi i I EVP-së dhe prokurori”.

Sikurse rezultojnë nga dokumentacioni dhe konstatimet e përshkruara më lart, anëtarët e komisionit të pritjes dhe të punonjësit e personelit shëndetësor të I EVP Lezhë nuk kanë kryer e përmbushur detyrat ligjore të parashikuara në nenin 30, paragrafi i 6, të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe e të paraburgosurve”, i ndryshuar, si dhe në nenin 13, pika 2, të VKM nr. 407 datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve” lidhur me të paraburgosurin M.Gj.. Anëtarët e komisionit të pritjes, megjithëse kanë parë dhe konstatuar shenjat dhe dëmtimet fizike të të paraburgosurit M.Gj., nuk i kanë pasqyruar e regjistruar ato në regjistrin e veçantë së bashku me shpjegimet e tij rreth rrethanave në të cilat i janë shkaktuara ato. Gjithashtu ata nuk kanë zbatuar edhe detyrimin ligjor për të njoftuar drejtuesin e I EVP-së dhe organin e prokurorisë lidhur me dhunimin e të paraburgosurit M.Gj. nga punonjësit e Policisë së Shtetit.

Gjatë hetimit administrativ të këtij rasti kontaktuar se, përfaqësuesi i sektorit ligjor Adrian Çeka, përfaqësuesi i sektorit të ruajtjes dhe sigurisë Ëngjëll Zefi dhe përfaqësuesi i sektorit të shëndetësisë Ndue Deda, kanë mbajtur qëndrim të kundërligjshëm. Me këto qëndrime të kundërligjshme mosvepruese të mbajtura nga shtetasit Adrian Çeka, Ëngjëll Zefi dhe Ndue Deda gjatë ushtrimit të funksionit të tyre shtetëror, si anëtar të komisionit të pritjes në I EVP Lezhë, kanë konsumuar elementët e figurës së veprës penale “Të shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal, i cili parashikon se: *“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbushje të regullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jo materiale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet dhe me gjobë nga treqind mijë deri në një milion lekë”.*

Objekt i këtij krimi, të kryer nga shtetasit Adrian Çeka, Ëngjëll Zefi dhe Ndue Deda, janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj, neni 30, paragrafi i 6, të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe e të paraburgosurve”, i ndryshuar dhe neni 13, pika 2, të VKM nr. 407 datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, për të siguruar veprimtarinë normale të aparatit shtetëror, (I EVP-së Lezhë), si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve

dhe të shtetit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni i cituar më lart nga veprimet ose mosveprimet kriminale. Mirëpo në rastin konkret janë cënuar rëndë këto marrëdhënie juridike, sepse duke moskryer detyrat konform dispozitave ligjore të cituara më sipër është cënuar veprimtaria normale e IEVP Lezhë, si dhe është dëmtuar rëndë imazhi i këtij institucioni. Në të njëjtën kohë është shkelur e drejta e shtetasit të paraburgosur M.Gj. për të bërë ankesë dhe provuar çënimin e integritetit të tij fizik për shkak të dhunës së ushtruar ndaj tij nga punonjësit e Policisë së Shtetit.

Nga ana objektive, në rastin konkret, krimi i “Shpërdorimit të detyrës” është kryer me mosveprime të kundërligjshme të shtetasve Adrian Çeka, Ëngjëll Zefi dhe Ndue Deda, duke mospasqyruar e regjistruar në regjistrin e veçantë shënjat dhe dëmtimet fizike të të paraburgosurit M.Gj. së bashku me shpjegimet e tij rreth rrethanave në të cilat i janë shkaktuar ato. Gjithashtu ata nuk kanë zbatuar edhe detyrimin ligjor për të njoftuar drejtuesin e IEVP-së dhe organin e prokurorisë lidhur me dhunimin fizik të të paraburgosurit M.Gj. nga punonjësit e Policisë së Shtetit.

Ata me cilësinë e anëtarëve të komisionit të pritjes së këtij institucioni nuk kanë zbatuar detyrimet që rrjedhin nga neni 30, paragrafi 6, të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe e të paraburgosurve”, i ndryshuar dhe neni 13, pika 2, të VKM nr. 407 datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”.

Subjekt i posaçëm i këtij krimi, siç u provua nga provat e administruara, janë përfaqësuesi i sektorit ligjor Adrian Çeka, përfaqësuesi i sektorit të ruajtjes dhe sigurisë Ëngjëll Zefi dhe përfaqësuesi i sektorit të shëndetësisë Ndue Deda, të cilët me mosveprimet e kundërligjshme nuk kanë zbatuar detyrimet ligjore. Ata janë madhor dhe të përgjegjshëm para ligjit.

Nga ana subjektive, ky krim është kryer nëpërmjet mosveprimit duke mospasqyruar e regjistruar në regjistrin e veçantë shënjat dhe dëmtimet fizike të të paraburgosurit M.Gj., si dhe duke mosnjoftuar drejtuesin e IEVP-së dhe organin e prokurorisë lidhur me dhunimin fizik të tij nga punonjësit e Policisë së Shtetit. Krimi është kryer me dashje të drejtpërdrejtë dhe në bashkëpunim me njëri-tjetrin të subjekteve të krimit Adrian Çeka, Ëngjëll Zefi dhe Ndue Deda. Ata e dinin që dispozitat ligjore të cituara më sipër i detyrojnë që të pasqyronin dhe regjistronin në regjistrin e veçantë shënjat dhe dëmtimet fizike të të paraburgosurit M.Gj., si dhe të njoftonin drejtuesin e IEVP-së dhe organin e prokurorisë lidhur me dhunimin e tij nga punonjësit e Policisë së Shtetit. Gjithashtu ata e dinin që moskryerja e veprimeve në përmbushje të rregullt të detyrës ishte i kundërligjshëm, sepse po çënonte veprimtarinë normale të IEVP Lezhë dhe po dëmtonte imazhin e këtij institucioni, si dhe interesat e ligjshme të shtetasit M.Gj., megjithatë këtë qëndrim mosveprues e kanë bërë me ndërgjegje të plotë.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe të nenit 21/ç, të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, në të cilin thuhet se: “*Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit..., i rekomandon prokurorisë të fillojë hetime në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një vepre penale, ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara*”, me shkresën nr. K2/Sh34-8 Prot., datë

29.07.2015, i rekomanduam Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë fillimin e hetimeve ndaj anëtarëve të komisionit të pritjes në IEVP Lezhë, Adrian Çeka përfaqësuesi i sektorit ligjor, Ëngjëll Zefi përfaqësuesi i sektorit të ruajtjes dhe sigurisë dhe Ndue Deda përfaqësuesi i sektorit të shëndetësisë, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 dhe 25 të Kodit Penal, të ndryshuar.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë me shkresën nr. 75/4 Prot., (A/P), datë 06.01.2016, na dërgoi vendimin e pushimit të hetimeve të procedimit penal me nr. 671, të vitit 2015.

Ndërmjet të tjerave nëpërmjet këtij vendimi vihemi në dijeni se, në datën 31.07.2015, ky organ ka regjistruar procedimin penal nr. 671 mbi bazën e kallëzimit të Avokatit të Popullit me objekt veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasve Adrian Çeka, Ëngjëll Zefi, Fatjona Sufaj dhe Ndue Deda.

Sipas këtij organi, nga aktet që ndodhen në dosjen hetimore rezulton se, në këtë organ ka bërë kallëzim Avokati i Popullit mbi faktin e pretenduar se pas ankesave të marra nga shtetasi M.Gj dhe familjarë të tij, një ekspert i Avokatit të Popullit ka kontaktuar me të paraburgosurin M.Gj.. Ky kontakt është bërë në datën 13.07.2015 në ambientet e paraburgimit të IEVP Shënkoll, Lezhë, ku janë konstatuar shenja dhune në fytyrë dhe në trup. Nga ana e kallëzuesit Avokatit të Popullit është pretenduar se ndaj të paraburgosurit M.Gj. është ushtruar dhunë në momentin e arrestimit të tij. Kjo dhunë nuk është evidentuar nga ana e komisionit të pritjes në momentin e mbërritjes së tij në IEVP Shënkoll, Lezhë. Ky mosevidentim sipas kallëzuesit përmban elementët e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Bashkëlidhur me kallëzimin janë dërguar:

1. Kopja e aktit të mbajtur në datën 08.07.2015 nga komisioni i pritjes i IEVP Shënkoll, Lezhë për shtetasin M.Gj.. Ky akt është mbajtur nga përfaqësuesi i sektorit juridik Adrian Çeka, përfaqësuesi i sektorit të ruajtjes dhe sigurisë Ëngjëll Zefi dhe përfaqësuesi i sektorit të shëndetësisë Ndue Deda. Për gjendjen shëndetësore për të paraburgosurin jepet ky përshkrim: “Aktualisht pa probleme, gjendja e tij shëndetësore e mirë”.

2. Kopja e kartelës ditore e të arrestuarit M.Gj. e përpiluar në Komisarariatit të Policisë Shkodër në datën 06.07.2015. Në këtë akt bëhet ky përshkrim: “Laceracione në pjesë të ndryshme të trupit”.

3. Dy fotografi të të paraburgosurit M.Gj., ku evidentohet ky shtetas me shënja dhune në gjoks, buzë, hundë dhe sy. Në prani të këtij shtetasi ndodhet një person i veshur me uniformë policie.

Vendimin për pushimit të hetimeve të procedimit penal nr. 671, të vitit 2015 organi i prokurorisë e mbështet në disa prova dhe konkluzione të arritura sikurse mund të përmendim:

- Kopjen e vërtetuar të kartelës klinike për të paraburgosurin M.Gj. në IEVP Shënkoll, Lezhë e hapur në datën 08.07.2015 dhe e plotësuar nga mjekja e intitucionit Fatjona Sufaj. Nga përmbajtja e kësaj karteje nuk evidentohet ndonjë shënjë dhune te i paraburgosuri.

- Deklarimet e shtetasve Adrian Çeka, Ndue Deda, Fatjona Sufaj dhe Ëngjëll Zefi me cilësinë e personave nën hetim, të cilët kanë shpjeguar se ata

kanë kontaktuar me të paraburgosurin M.Gj. dhe me sy të lirë nuk kanë konstatuar shënja dhune dhe se ky shtetas nuk ka shfaqur ndonjë pretendim të tillë.

- Deklarimet e shtetasit M.Gj., i cili ka shpjeguar se në momentin e arrestimit është dhunuar nga punonjësit e policisë. Shënjat e dhunës i ka pasur në pjesë të ndryshme të trupit madje edhe në momentin e mbërritjes në IEVP Shënkoll, Lezhë. Në këtë moment ai ka pasur shënja dhune në fytyrë, trup, këmbë e gjoks. Ai është vizituar nga mjekja e institucionit, të cilës i ka paraqitur pretendimet për dhunën e ushtruar dhe ajo i ka vërejtur këto dëmtime. Përveç sa më sipër, ai ka deklaruar se ka kontaktuar me një specialist të Avokatit të Popullit në IEVP Shënkoll, Lezhë. Ndërsa i pyetur për fotografitë e dërguara nga Avokati i Popullit ai ka shpjeguar se ato i ka bërë motra e tij me celular në ambientet e banesës në momentin e arrestimit të tij.

- Kartelën e mbajtur nga Komisariati i Policisë Shkodër ku evidentohen fotografi të shtetasit M.Gj., nga të cilat nuk evidentohen shenja dhune në fytyrë.

- Deklarimet e punonjësit të policisë Dedë Zefi që ka bërë transferimin e M.Gj. nga Komisariati i Policisë Shkodër në IEVP Shënkoll, i cili ka shpjeguar se ka konstatuar vetëm gërvishje në qafë.

- Deklarimet e ndihmësmjekut të policisë Lulzim Kukaj, i cili ka shpjeguar se me shënimin që ai ka bërë në kartelën ditore të shtetasit M.Gj. "Laceracione në pjesë të ndryshme të trupit" nënkupton gërvishje sipërfaqësore në qafë, bark, të cilat kishin filluar të thaheshin dhe janë trajtuar nga ana e tij me pomadë.

- Deklarimet e punonjësit të policisë Bahri Laçi (Laçaj), i cili ka qënë prezent dhe është fotografuar së bashku me M.Gj. nga motra e këtij të fundit në banesë. Ky ka shpjeguar se, tek ky shtetas nuk ka parë shenja dhune në fytyrë apo trup.

- Akti i ekspertimit me nr. 152, i datës 23.07.2015 i shtetasit M.Gj, sipas të cilit tek ky shtetas nuk konstatohen dëmtime trupore.

- Vendimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër për mosfillimit të procedimit penal të kallëzimit me nr. 1786, të vitit 2015, të bërë nga prindërit e shtetasit M.Gj. shtetasit Sh. dhe Gj.Gj., për dhunën e ushtruar ndaj M. nga punonjësit e policisë në momentin e arrestimit të tij. Nga ky vendim rezulton se, pas arrestimit i paraburgosuri është kontaktuar nga avokati i tij dhe prokurorja e çështjes dhe ai nuk ka paraqitur pretendime për dhunën e ushtruar ndaj tij. Gjithashtu ky shtetas nuk ka paraqitur pretendime për dhunë as në seancën gjyqësore të masës së sigurimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Këto pretendime ai i ka paraqitur vetëm në Gjykatën e Apelit Shkodër. Sipas prokurorisë, nëse këto pretendime do të ishin paraqitur apo nëse nga prokurorja e çështjes do të konstatoheshin këto dëmtime (të cilat po të kishin ekzistuar në masën e paraqitur në fotografi nuk mund të mosevidentoheshin në fytyrë), atëhere prokurorja e çështjes do të ishte e detyruar ta bënte të ditur faktin, madje edhe të fillonte ndjekje penale për këtë fakt, gjë që nuk ka ndodhur.

- Në këtë vendim arsyetohet se, nëse këto shënja do të ishin të pranishme gjatë shqyrtimit të masës së sigurimit personal të të paraburgosurit, gjyqtarja e cila ka shqyrtuar këtë çështje do të kishte bërë kallëzim apo informacion për fillimin e ndjekjes penale, gjë që nuk ka ndodhur.

- Në faktin që kallëzimi i bërë nga familjarët e shtetasit M.Gj. rezulton të jetë bërë 10 ditë pas arrestimit të tij dhe jo në momentin e arrestimit.

- Në faktin që, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, e cila ka hetuar kallëzimin për ushtrim dhune ndaj të paraburgosurit nga punonjësit e Policisë së Shtetit, ka konkluduar se nuk provohet ekzistenca e kësaj dhune. Për këtë shkak nga ana e kësaj prokurorie fakti i kallëzuar është mosfilluar dhe deri në momentin e mbërritjes së përgjigjes nga kjo prokurori ky vendim ka qënë në fuqi.

- Në faktin që fotografitë e shtetasit M.Gj. të paraqitura nga Avokati i Popullit nuk kanë asnjë të dhënë që provojnë origjinalitetin e tyre.

Lidhur me faktet, arsyetimet dhe konkluzionet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë mbi të cilat ka bazuar këtë vendim, të cilat i cituam më sipër, sqarojmë se:

Mosngritja para prokurorit dhe gjykatës nga shtetasi M.Gj. apo mbrojtësi i tij i pretendimeve për dhunim fizik nga punonjësit e policisë, apo bërja e kallëzimit për këtë problem nga prindërit e tij me 10 ditë vonesë nuk përbëjnë provë për ti rrëzuar ato si të pabazuara. Arsyet e kësaj vonesë mund të jenë nga më të ndryshmet, si nga padija e të arrestuarit dhe e prindërve të tij për të bërë ankim, nga tronditja psikologjike që kanë pësuar ata nga arrestimi i Maringlenit, nga motive dhe qëllime për të mosacaruar situatën me policinë, etj.

Për hirë të së vërtetës ankesa e të ëmës së tij, shetases Sh.Gj., pranë institucionit tonë është bërë me shkrim në datën 11.07.2015 dhe jo me 10 ditë vonesë, sikurse konkludon organi i prokurorisë.

Mosfillimi i ndjekjes penale për këtë fakt nga prokurori i çështjes dhe mosbërja e kallëzimit apo informacionit për fillimin e ndjekjes penale nga gjyqtari që ka shqyrtuar masën e sigurimit personat të të paraburgosurit M.Gj., nuk do të thotë domosdoshmërisht që ata nuk i kanë parë shënjat e dhunës në fytyrën e tij apo që ai nuk është dhunuar nga punonjësit e policisë në momentin e arrestimit të tij.

Nga përvoja e deritanishme kemi konstatuar raste që, megjithëse të arrestuarit kanë qënë me shënja të dukshme dhune, nga organet e prokurorisë dhe të gjykatës nuk është vepruar për të urdhëruar fillimin e hetimit kryesisht. Sqarojmë se edhe ky qëndrim, ndonëse i kundërligjshëm, ka arsyet e veta, të cilat janë të ndryshme nga njëri rast në tjetrin.

Theksojmë se, ky konkluzion e prokurorisë rrëzohet *nga konstatimi i bërë nga punonjësi i institucionit tonë kur ka marrë kontakt me të paraburgosurin në IEVP Shënkoll në datën 13.07.2015 dhe nga deklaratimet e dhëna me shkrim para punonjësve të institucionit tonë nga dy punonjësit e policisë Gjergj Ashta dhe Bahri Laçaj të cilët pohuan se, kur e morën në dorëzim Maringlenin nga forcat speciale kanë konstatuar se ai kishte disa dëmtime në fytyrë dhe në trup, si dhe nga deklaratimet e dhëna nga shtetësja Xh.Gj.*

Deklarimet e bëra para organit të prokurorisë nga punonjësi i policisë Bahri Laçi (Laçaj), i cili ka qënë prezent dhe është fotografuar së bashku me Maringlenin nga motra e këtij të fundit në banesë, se *tek ky shtetas (M.) nuk ka parë shënja dhune në fytyrë apo trup, janë në kundërshtim të plotë me deklaratimet e dhëna me shkrim para punonjësve të institucionit tonë nga ai dhe kolegu i tij Gjergj Ashta. Në procesverbalet e pyetjes së tyre në datën 15.07.2015 ata pohuan se, kur e morën në dorëzim M. nga forcat speciale kanë konstatuar se ai kishte disa dëmtime në fytyrë dhe në trup.*

Gjatë hetimeve të këtij procedimi konstatojmë se nuk janë pyetur familjarët e shtetasit M.Gj. dhe veçanërisht motra e tij, Xh.Gj., e cila e ka parë

atë të dhunuar dhe ka bërë fotot e tij me shënjat e dhunës. Ndonëse në rekomandimin tonë është sqaruar origjina e fotografive dhe personin që i ka bërë ato, por nga organi i prokurorisë nuk është kryer asnjë veprim hetimor për të sqaruar e vërtetuar këtë fakt të rëndësishëm.

Lidhur me vendimin e datës 14.09.2015 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër për mosfillimin e procedimit penal nr. 1786, të vitit 2015, i cili është administruar në dosjen hetimore si një nga provat për pushimin e hetimeve e procedimit penal me nr. 671, të vitit 2015 sqarojmë se, mbi bazën e rekomandimit të Avokatit të Popullit drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm në datë 15.12.2015, Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. 3899/4ex-15 Prot./A.L., datë 24.02.2016, na informoi se është vendosur shfuqizimi i këtij vendimi.

Nga përmbajtja e këtij vendimi të cilin e përshkruam më sipër konstatojmë se, qëndrimi i mbajtur nga organi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë në lidhje me rekomandimin e bërë nga institucioni ynë, duke vendosur pushimin e procedimit penal me nr. 671, të vitit 2015 është i kundërligjshëm. Nga ky organ nuk janë bërë hetime të plota, të gjithanshme dhe objektive. Ndërkohë konstatojmë se hetimet e kryera janë subjektive, të njëanshme dhe dëmtojnë rëndë reputacionin dhe imazhin e organit të prokurorisë në publik. Gjithashtu ky qëndrim shkel hapur të drejtat kushtetuese e ligjore të shtetasit M.Gj..

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit, 63 të Kushtetutës ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, respektivisht në nenin 21/ç, të në të cilin parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit..., i rekomandon prokurorisë të fillojë hetime në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një vepre penale, ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara”*; si dhe në nenin 21/c të tij ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit..., paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen,”*

REKOMANDOJMË:

1. Ndërhyrjen tuaj si organ epror dhe ushtrimin e kompetencave ligjore bazuar në nenin 24/5 të Kodit të Procedurës Penale, duke shfuqizuar vendimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë për pushimin e hetimeve të procedimit penal me nr. 671, të vitit 2015.

2. Urdhërimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë për rifillimin dhe vazhdimin e hetimeve të procedimit penal me nr. 671, të vitit 2015. Kryerjen e hetimeve të plota, të gjithanshme dhe objektive në ngarkim të anëtarëve të komisionit të pritjes në IEVP Lezhë, Adrian Çeka përfaqësuesi i sektorit ligjor, Ëngjëll Zefi përfaqësuesi i sektorit të ruajtjes dhe sigurisë dhe Ndue Deda përfaqësuesi i sektorit të shëndetësisë, si dhe mjekes së këtij institucioni Fatjona Sufaj për veprën penale të *“Shpërdorimit të detyrës”*, e kryer

në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 dhe 25 të Kodit Penal, të ndryshuar.

Për shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe qëndrimin që do të mbani ndaj tij, lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, konform nenit 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Bashkëlidhur ju dërgojmë me cilësinë e provave dokumentet e më poshtme:

1. Vendimi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë për pushimin e hetimeve të procedimit penal me nr. 671, të vitit 2015.

2. Procesverbali i pyetjes së shtetasit Xh.Gj, i mbajtur në datën 15.07.2015.

3. Procesverbali i pyetjes së shtetasit Gjergj Ashta, i mbajtur në datën 15.07.2015.

4. Procesverbali i pyetjes së shtetasit Bahri Laçaj, i mbajtur në datën 15.07.2015.

5. Kartela ditore e shtetasit M.Gj. e përpiluar në datën 06.07.2015 nga nd/mjeku i Komisarariatit të Policisë 731 FNSH Shkodër Lulzim Kukaj.

6. Dy fotografi të shtetasit M.Gj. bërë në datën 04.07.2015.

7. Procesverbali i komisionit të pritjes në IEVP Lezhë mbajtur në datën 08.07.2015 lidhur me të paraburgusurin M.Gj..

8. Shkresa e Prokurorisë së Përgjithshme nr. 3899/4ex-15 Prot./A.L, datë 24.02.2016, drejtuar Avokatit të Popullit, me lëndë “Përgjigje për rekomandimin e dërguar me shkresën nr. prot., K2/Sh34-23, datë 15.12.2015”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Në mungesë dhe porosi

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI